



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1051 Prot.

Tiranë, më datë 02.12.2021

**VENDIM**  
**Nr. 656, datë 02.12.2021**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit dhe Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik të realizuar nga individ i licencuar në veprimtari arkeologjike z. Luan Përzhita në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 02.12.2021:

**VENDOSI:**

1. Mosmiratimin e projektit “Studim tekniko ekonomik dhe Projekti I shfrytëzimit të gëlqerorëve Leja minerare e shfrytëzimit Nr. 1305, Dorëz, Tiranë”, brenda kufirit të Zonës Mbrojtëse të Kalasë së Dorëz, me aplikues Denis Stasa, zhvillues “A.G. Invest” sh.p.k.;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Rudina ZOTO

